REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

Komuna e Suharekës
Zyra për Informim
07Nr.620
Me datë: 15.10.2026

15.10.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

MARRË NË DORËZIM-PRIMLJENO-RECEIVED

Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
07	016	51771	3

Bazuar në Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174, neni 5 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.3, neni 11 paragrafi 1 pika 1.15 neni 17 dhe 20,UA Nr.05/2014 për përgjegjësit a autoritetit të planifikimit hapësinorë si dhe parimet dhe procedurat për pjesmarrjen e publikut në planifikim hapësinorë neni 8, Komuna e Suharekës ju fton në:

SHQYRTIM PUBLIK

Për: Propozim PRRH ZONA EKONOMIKE DUHËL

Datë:26.10.2026 deri më 24.11.2026

Vendi:Objekti i Komunës së Suharekës

Prezantimi i dokumentit nga Komuna e Suharekës do të mbahet:

Datë: 26.10.2026 (E hënë)

Ora: 11:00

Vendi: Salla e Asamblesë Komunale në Shtëpinë e Kulturës- Suahrekë

Komuna e Suharekës përmes konkursit të projektimit ka hartuar-"Planin Rregullues te Hollesishem-ZONA EKONOMIKE DUHËL", ku si bartës i këtij procesi është Drejtoria për Urbanizëm Planifkim dhe Mjedis në bashkëpunim me drejtoritë sektoriale të Komunës dhe kompaninë "INSI", me seli në Prishtinë (në cilesinë e hartuesit). Për finalizmin e PRrH ZONA EKONOMIKE DUHËL, para aprovimit final ky, propozim dokument shpallet në shqyrtim publik për **30 ditë,** para qytetarëve, ekspertëve dhe palëve të interesuara që atakohen nga zhvillimi i kësaj zonë të komunës në 8 (tetë) vitet e ardhshme.

Komuna është e përkushtuar të bashkëpunojë ngusht me të gjitha palët e interesuara, që janë të gatshëm të kontribojnë në përgatitjen e një dokumenti të qëndrueshëm dhe lehtë të zbatueshëm. Andaj, ju ftojmë të jeni pjesë e këtij shqyrtimi dhe diskutimi publik, ku pjesëmarrja dhe kontributi juaj do të mundësojë një planifkim të mirëfilltë, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës në komunën tonë.

Dokumentin mund ta gjeni në linkun : https://suhareke.rks-gov.net/urbanizem-dhe-planifikim/

Shqyrtimi publik do të zgjat **30 ditë,** nga data 26.10.2026 – 24.11.2026, ku të gjithë të interesuarit mund të japin komente, vërejtje apo sugjerime, të cilat do të shqyrtohen me profesionalizëm dhe korrektësi të plotë. Takime publike konsultative me qytetarë gjatë shqyrtimit publik do të ketë çdo ditë pune pranë zyrave të DUPM-së Komentet mund të dorëzohen zyrtarisht në mënyrë fizike në Drejtorinë për Urbanizëm Planifkim dhe Mjedis, apo përmes formës elektronike në email urbanizmisuhareke@rks-gov.net dhe visar.kuqi@rks-gov.net

Drejtori i Drejtorisë:
Visar KUÇI